



FK BYLIS

# DOSJE SPONSORIZIMI

2025-2026



**PREPARED BY :**

17K.Production  
(Danil KODHELAJ)

# PËRMBLEDHJA

1  
2  
3  
4  
5  
6  
7

PREZANTIMI I KLUBIT

---

HISTORIA E KLUBIT

---

AMBICIET, VLERAT, DHE ARRITJET TONA

---

INFRASTRUKTURA E KLUBIT

---

KATEGORIA AKTUALE

---

PARTNERITETI & SPONSORIZIMI

---

NA KONTAKTONI



# 1

## PREZANTIMI I KLUBIT

**KF Bylis Ballsh** është një klub futbollit i themeluar në vitin 1972, i afiluar pranë Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF). Klubi drejtohet nga **Besnik Kapllanaj**, i cili mban postin e presidentit prej më shumë se dy dekadash, duke garantuar stabilitet, vizion dhe vazhdimësi në zhvillimin e klubit.

KF Bylis disponon një akademi futbollit për meshkuj dhe femra, me rreth 100 deri në 200 sportistë të licencuar, e cila përbën bazën kryesore të projektit sportiv të klubit.

Në futbollin mashkullor, klubi përfaqësohet nga disa ekipe konkurruese:

- Ekipi i parë (A), i cili garon në Abissnet Superiore (K1),
- Ekipi rezervë (B), që merr pjesë në Kategorinë e Dytë (K3),
- Ekipi U19, i cili konkurren në divizionin e parë të kategorisë së tij.

KF Bylis Ballsh është një klub që vë theks të veçantë te rinia, formimi i talenteve dhe promovimi i futbollit shqiptar, me objektiv zhvillimin e qëndrueshëm sportiv dhe ndërtimin e një të ardhmeje të fortë për klubin.





## 2 HISTORIA E KLUBIT

KF Bylis Ballsh u themelua më 14 korrik 1972 nën emrin “Ballshi i Ri” dhe ka ndërtuar me kohë një traditë të fortë në futbollin shqiptar.

Në fillimet e tij, klubi konkurronte në divizionet e ulëta të futbollit shqiptar, duke kaluar nëpër sfida të ndryshme dhe duke u rritur gradualisht në strukturë dhe performancë. Në sezonin 1995–96, Bylis fitoi promovimin për herë të parë në Kategoria Superiore, nivelin më të lartë të futbollit në Shqipëri, pas një sezoni të jashtëzakonshëm me rezultatet më të mira në ligë.

Pas debutimit në Superiore, klubi përsëri u konsolidua me paraqitje solide; pikërisht në sezonin 1998–99, Bylis arriti vendin e tretë në kampionat, duke siguruar kështu edhe kualifikimin për herë të parë në një kompeticion europian, UEFA Cup.

Gjatë viteve të mëpasshme, klubi ka kaluar luhatje midis divizioneve, por ka treguar gjithmonë shpirt konkurrues dhe rezistence, duke rikthyer shpesh pozitën e tij në Superiore. Bylis ka fituar disa herë Kategoria e Parë, duke siguruar promovime të rëndësishme drejt elitës së futbollit shqiptar.

Klubi ka marrë pjesë në kompeticione ndërkombëtare, si UEFA Cup dhe UEFA Intertoto Cup, duke përfaqësuar me krenari qytetin e Ballshit dhe futbollin shqiptar në arenën e jashtme.

Për më shumë se 40 vjet, Bylis Ballsh ka treguar një angazhim të qëndrueshëm për rritjen e niveleve sportive dhe për zhvillimin e talenteve të reja, duke krijuar një identitet të respektuar në futbollin kombëtar.



# 2 HISTORIA E KLUBIT





# 3 AMBICIET, VLERAT, DHE ARRITJET TONA

KF Bylis Ballsh ka si ambicie zhvillimin e qëndrueshëm sportiv dhe forcimin e pozicionit të tij në futbollin shqiptar. Klubi synon të ndërtojë një projekt afatgjatë, të bazuar në stabilitet, profesionalizëm dhe rezultate të qëndrueshme.

Vlerat kryesore të KF Bylis janë puna, respekti, përkushtimi dhe fryma e ekipit. Klubi i kushton rëndësi të veçantë formimit të të rinjve, promovimit të talenteve vendas dhe përfaqësimit dinjitoz të qytetit të Ballshit në garat kombëtare.

Përmes këtyre vlerave, KF Bylis synon të kontribuojë në zhvillimin e futbollit shqiptar dhe në ndërtimin e një identiteti sportiv të fortë dhe të respektuar.



Kategoria e Parë (x5)



Kategoria e Dytë (x2)



Kategoria e Tretë (x2)



Finalist i Kupës së Shqipërisë (x1)



Pjesëmarrje në UEFA Liga e Evropës (x1)



Pjesëmarrje në UEFA Kupa Intertoto (x1)



"U19" : Kampion Kategoria e Parë - Superiore & Pjesëmarrje në UEFA Young League



"B" Kampion Kategoria e Tretë



"U21" Kampion Kategoria Superiore (x3)



## 4 INFRASTRUKTURA E KLUBIT



### *Stadiumi Adush Muçaj*

- *Kapaciteti: rreth 2500 vende*
- *Fushë me bar natyral: 110x75 metra*
- *+ 260 metra hapësirë publicitare*




### *Kompleksi Bylis dhe mjetet e udhëtimit*

- *Fushë stërvitore 90x60 metra me hapësirë publicitare 90 m*
- *Bar / Club House në qendrën e qytetit të Ballshit*
- *Klubi disponon 1 autobus dhe disa furgona, të cilët përshkojnë një distancë rrugëtimi sezonale prej më shumë se 10,000 km.*

### *Rrjetet Sociale*

- *Faqe zyrtare "Website" dhe disa rrjete sociale, duke grumbulluar mbi 15,000 ndjekës, me më shumë se 5,000 shikime për postim dhe mbi 350,000 shikime në muaj. Një aset publicitar në ekspansion të plotë.*





# 5 KATEGORIA AKTUALE



Abissnet Superiore përfaqëson majën e futbollit në Shqipëri. Ky kampionat është elita e sportit shqiptar, i përbërë nga 10 klubet më të mira të vendit dhe organizohet nën patronazhin e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF). Ky është kompeticioni ku garohet për titullin kampion dhe për një vend në arenën ndërkombëtare (UEFA Champions League dhe Conference League), duke garantuar një nivel të lartë rivaliteti dhe vëmendje maksimale nga publiku.



Çdo ndeshje e kampionatit transmetohet drejtpërdrejt nga RTSH (Radio Televizioni Shqiptar), transmetuesi publik kombëtar.

- Mbulimi Televiziv: Ndeshjet transmetohen falas në çdo shtëpi shqiptare përmes kanaleve kombëtare.
- Prezenca Digjitale: Përveç ekranit, RTSH garanton një shtrirje të gjerë përmes rrjeteve sociale dhe kanalit zyrtar në YouTube, duke rritur ndjeshëm ekspozimin e logove të sponsorëve në kohë reale.



Për herë të parë, futboli shqiptar ka arritur një audiencë globale. FIFA+, platforma zyrtare e FIFA-s, transmeton falas dhe në integritet të plotë të gjitha ndeshjet e Abissnet Superiore për shikuesit ndërkombëtarë. Kjo platformë ofron:

- Vizibilitet Global: Mundësi që marka juaj të shihet nga fansa dhe investitorë në mbarë botën.
- Qasje pa pagesë: Çdokush, kudo në botë, mund të ndjekë ndeshjet tona në uebsajtin e FIFA+, duke i dhënë partnerëve tanë një dritare unike në tregun ndërkombëtar.



## 6 PARTNERITETI & SPONSORIZIMI

Më poshtë do të gjeni ofertën tonë të strukturuar në katër nivele kryesore, të krijuara për të maksimizuar dukshmërinë e markës suaj përmes kanaleve tona fizike dhe digjitale:

Paketa Sponsorizimi	Përshkrimi i paketës
<b>Bazë</b>	Visibilitet në rrjetet sociale të klubit (15,000 ndjekës, 5,000 shikime për postim, 350,000 shikime minimale në muaj) dhe logo=link në website e klubit
<b>Standard</b>	Rrjetet sociale + Ekspozim në panelet e stadiumit kryesor (260 m) dhe/ose stadiumit stërvitor (90 m)
<b>Premium</b>	Rrjetet sociale + Panelet e stadiumit + Ekspozim në një ose disa automjete të klubit (10,000 km/ vit)
<b>Ultimate</b>	Rrjetet sociale & website + Panelet e stadiumit dhe/ose në qëndrën stërvitore + Automjetet me logon tuaj (të gjitha) + Logo tek veshjet e klubit + Bileta falas për ndeshjet tona në shtëpi

Çdo paketë mund të përshtatet sipas nevojave tuaja. Ju lutemi na bëni të ditur prioritetet tuaja dhe do t'i rregullojmë gjatë negociatave.



# 7

## NA KONTAKTONI

FK BYLIS

Për çdo informacion zyrtar, publikime, njoftime ose materiale mediatike, ju lutemi ndiqni kanalet tona zyrtare më poshtë.

Rrjetet sociale zyrtare të klubit:

- Instagram: [@bylisa1](https://www.instagram.com/bylisa1)
- Facebook: [facebook.com/bylis.al](https://www.facebook.com/bylis.al)
- YouTube: [FKBylis](https://www.youtube.com/FKBylis)

Faqja zyrtare e klubit:

[www.fkbylis.al](http://www.fkbylis.al)

Email zyrtar për marketing & media:

[fkbylismedia@gmail.com](mailto:fkbylismedia@gmail.com)

Për çdo pyetje lidhur me mundësitë e partneritetit ose sponsorizimit, ju lutemi ndiqni hapat e mëposhtëm:

### 1. Kontakti i parë:

- Menaxher Marketingu: Danil KODHELAJ
- Email: [danilkodhelajpro@gmail.com](mailto:danilkodhelajpro@gmail.com)
- WhatsApp: +33 7 49 17 26 36

*Ky është kontakti ideal për të diskutuar mundësitë e sponsorizimit dhe për të shpjeguar interesin tuaj.*

### 2. Elaborimi ligjor / kontratat:

- Administrator i klubit: Arber SINO
- Email: [bylissha@outlook.com](mailto:bylissha@outlook.com)
- Tel: +355 69 3670 618

*Pas kontaktit të parë, kontaktoni administratorin për çështjet ligjore dhe përgatitjen e kontratës.*

### 3. Finalizimi dhe miratimi:

- Presidenti i klubit: Besnik KAPLLANAJ
- Tel: +355 69 663 5586

*Finalizoni marrëveshjen me presidentin për aprovimin përfundimtar.*